

# Statuti I Shoqerise “DaCo al”

Në këtë statut

- “Ligji” është Ligji Nr. 9901, dt.14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”;
- “Statuti” është Statuti I shoqërisë;

## **Kreu I**

**Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia**

### **Neni 1:**

**Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit**

(1) Sot më 01/03/2023, unë, themeluesi Ramadan Merko, lindur 15/04/1996 në Tepelene, banues në Tirane, i pajisur me nr personal J60415023C kam krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin "Da&Co al" SH.P.K.

(2) Themeluesi i shoqërisë është (mbiemrat, emrat ose forma dhe emir ligjor I shoqërisë; Adresat ose selia e numri dhe vendi I regjistrimit):

- Ramadan Merko me numer personal: J60415023C

### **Neni 2:**

#### **Objekti**

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

Import dhe eksport, tregti me pakice dhe shumice, konsulence teknike, instalim, mirembajtje per: paisje kompjuterike, kancelarie,telefonie, elektronike, mekanike, te telekomunikacionit, elektrike, hidraulike, i sistemeve te fonise, sistemeve te alarmit kundra vjedhjes, sistemeve te alarmit kundra zjarrit, sistemeve te rrufepitjes, sistemeve te kamerave te survejimit dhe vezhgimit CCTV, sistemeve te akses kontrollit, sisteme UPS, stabilizatore, gjeneratore, radio nderlidhje, sisteme me fiber optike etj. Tregti me pakice dhe shumice per paisje laboratorike per ruajtjen dhe restaurimin e pasurive kulturore dhe artistike di dhe servis dhe mirembajtje per keto paisje. Konsulence teknike, riparim dhe servis per paisje kompjuterike dhe elektronike. Ndertim linjash elektrike mbitokesore, ajrore, nentokesore, kabllore per energjine elektrike, linja fuqie dhe telekomunikacioni, nenstacione elektrike te larta e te mesme. Sherbime informatike dhe telefonike. Shperndarje interneti. Krijim dhe mirembajtje faqesh interneti. Programim, krijim dhe shperndarje programe kompjuterike. Sherbime operator per hedhje dhe regjistrim te dhenash te ndryshme. Tregtim, servis, kalibrim, mirembajtje per ene, pajisje dhe aparatura 2 laboratorike. Shitje, riparime dhe mirembajtje ashensoresh. Tregtim me shumice dhe/ose pakice te pajisjeve Mjekesore. Trajnime dhe certifikime profesionale ne fushen e Teknologjise Informatike, teknikave te shitjes, marketingut. Shit blerje librash, botimete ndryshme.

Tregtim, instalim, mirembajtje e produkteve per sisteme monitorimi CCTV (analog, IP, etj), sisteme Access Control, sisteme kundra zjarrit. Shit-blerje, tregtim dhe import-eksport artikuj kancelarie, leter printimi, shtypshkrime te ndryshme, bojra tonera per printera e fotokopjues dhe per çdo pajisje tjeter te teknologjise informatike.

Sherbimi i kerkimit dhe mbledhja e informacionit tregtar në emër të palëve të treta; Aktiviteti i importimit, futjes, azhornimit, përpunimit, eksportimit dhe analizës së të dhënave të strukturuar dhe të pa strukturuar për palët e treta; Projektimi, realizimi, instalimi dhe mirëmbajtja e bazave të të dhënave dhe software-t përkatës, që synojnë ofrimin e mjeteve to domosdoshme për analizimin e klienteles dhe tregut, si dhe mjete për gjenerimin e mundësive te reja te tregut; Organizimi i të dhënave në bazën e të dhënave, përfshirë verifikimin dhe vlerësimin e saktësisë, qëndrueshmërisë dhe tërësisë së të dhënave me qëllim lehtësimin e

hyrjes ne bazen e te dhenave, nxjerrjes dhe interpretimit e ketyre te fundit; Aktiviteti i perpunimit te te dheneve permes integrimin, grupimit dhe normalizimit te te dheneve ne bazen e te dheneve per një pamje me të plotë dhe të integruar të klienteles; Menaxhimi i arkivimit, ruajtjes dhe procedurave të rigjenerimit dhe mbrojtjes së të dhënave; Aktiviteti i Big Data Analysis & Marketing permes përdorimit të proceseve, mjeteve dhe teknologjive të nevojshme për të përpunuar informacionin e nevojshëm për përcaktimin e modeleve të analizës territoriale dhe modeleve parashikuese të sjelljes; Realizimi i aktiviteteve të kërkimit, zhvillimit dhe konsulencës në fushën e sistemeve të informacionit të drejtuar nga të dhënat dhe me perberje te larte teknologjike; Aktivitetet e Shërbimit drejt Konsumatorit

Customer Service dhe Kujdesit drejt Konsumatorit (Customer Care), me suport telefonik dhe web, përfshirë aktivitetet e Telemarketingut dhe te metodologjise Quality Call për të zhvilluar mundësi te reja biznesi; Aktiviteti i backoffice, kontabilitetit dhe administratës në burimet e jashtme (outsourcing). Kompania mund të kryejë të gjitha veprimet tregtare, industriale, mbi pasuritë e tundshme e te patundshme, operacionet financiare dhe bashkëpunuese të cilat konsiderohen të nevojshme nga organi administrativ për arritjen e qëllimit të kompanise. Gjithashtu mund të kete, jo per qellim vendosjeje, interesa dhe aksione direkte dhe indirekte në shoqeri ose kompani të tjera që kanë një objekt të ngjashëm ose të lidhur me të vetin. Kompania, ne menyre jo te shpeshte e mbizoteruese dhe me funksion ekskluzivisht instrumental për arritjen e qëllimit të korporatës e cila gjithsesi vete perjashtohet ne menyre te qarte ndaj çdo aktiviteti të kryer drejt publikut, mund të japë garantdhenie dhe garanci në favor të palëve të treta.

Konfigurimi i llogarisë dhe Organizimi i kalendarit të mediave sociale, optimizimi i faqeve të biznesit dhe menaxhimi i nxitjes së reklamave, Strategjia e mediave sociale, Menaxhimi i llogarisë, analiza e konkurrentëve të mediave sociale, postimet në javë dhe ditore

### **Neni 3: Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë e papërcaktuar.

### **Neni 4: Selia**

(1) Selia e shoqërisë ndodhet ne adresën: Rr. “Taulantia” Lagja 1 Nd. Hotel Arvi, 2001, Durrës

### **Kreu II Kapitali**

#### **Neni 5 Kapitali Themeltar**

(1) Kapitali themeltar fillestar I shoqërisë është:10.000 Lekë (Dhjetë mije leke)

Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

1.Ortaku themelues Ramadan Merko: Zoteruesi 1 (nje) kuote me vlerë të përgjithshme që përben 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë të barabartë me 10.000 lek.

Kapitali për momentin është i pa ndarë.

Kapitali të shtohet ose të pakësohet në përputhje me ligjet Shqipëtare.

Kontributi i ortakëve do të jetë në para.

## **Neni:6**

### **Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit**

Kapitali I shoqërisë mund të zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi I kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen përndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi I prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

## **Neni7**

### **Transferimi I kapitalit**

Kuota te kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitb lerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe ne statut.

Pjesë te kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

## **Kreu III**

### **ORGANET VENDIMARRESE DHE DREJTUESE**

## **Neni 8**

### **Organi Vendimmarrës**

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modalite te vete percaktuara ne ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështje të mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshime të statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “ç” të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojë në si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

## **Neni 9**

### **Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblese së Përgjithshme**

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

## **Neni 10**

### **Kuorumi**

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 përqind të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit "Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur më lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

## **Neni 11**

### **Marrja e vendimeve**

Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të zotëruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si:

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecuresisë së veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Cdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKR për të pasqyruar ndryshimet në skeden e shoqërisë.

## **Neni 12**

### **Përfundimi nga e drejta e votës**

1.Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:

- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- ç) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

2. Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

### **Neni 13**

#### **Administrimi**

(1) Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

(2) Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.

(3) Personat e mëposhtëm caktohen si Administratorë të parë të shoqërisë deri në emërimin e tyre nga mbledhja e parë e Asamblesë së Përgjithshme.

Të dhënat e identifikimit

- Ramadan Merko me numer personal: J60415023C Adresa Rr “ADEM JASHARI” Nd. 15, H 11, Ap. 5, Njesia Administrative Nr.5, 1019, Tirane.

### **Neni 14**

#### **Kompetencat e Administratorëve**

Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratorët janë të detyruar të therasin Asamblenë e Përgjithshme, në rastet kur:

-sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.

-shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuar.

-shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuar.

Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

## **Neni 15**

### **Pergjegjesite e Administratorit**

Administratori eshte pergjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare “, administratori detyrohet:

1. a) të kryejë detyrat e tij te përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;

b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;

c) të vlerësojë me pergjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;

ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;

d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, pergjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, eshte i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata pergjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori eshte i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit „ Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare, kryen veprimet e mëposhtme:

a) u kthen ortakëve kontributet;

b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;

c) u shpërndan aktivet shoqërisë;

ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;

d) jep kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit

Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

## **Kreu IV**

### **Viti financiar-ekspertet**

## **Neni 16**

## **Viti Financiar**

Viti financiar i Shoqërise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqërise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

### **Neni 17**

#### **Ekspertet**

Eksperti ka per detyre qe të kontrolloje të gjithë dokumentacionin kontabel të veprimtarise ekonomiko tregtare të shoqërise, ate gjithëvjetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje të tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.

Ne perfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike të ushtruara, të cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e të drejtes vendimore qe ka.

#### **Kreu V**

Prishja –riorganizimi i shoqërisë

### **Neni 18**

#### **Prishja dhe likuidimi**

Shperndarja ose prishja e shoqërise mund të behet ne cdo kohe:

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të Asamblese se Ortakeve;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;
- d) me vendim të gjykatës;

Ne kete rast Ortaket merrin vendim me shkrim ne të cilin parashikojne menyren e likuidimit të shoqërise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese “Shoqeri ne likuidim e siper “.

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket.

Nëse Ortaket nuk merrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

### **Neni 19**

#### **Riorganizimi i shoqërisë bashkimi-ndarja**

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vednimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.”

### **Neni 20**

**Baza Ligjore**

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjetër specifik ne Republiken e Shqiperise.

**Neni 21****Mosmarrëveshjet**

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptar.

**ORTAKET****E SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

Daco al

Emer mbiemer  
Ramadan Merko

(nen shkrimi)